



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 2, Datë 05.05.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR PUNIMET CIVILE TË “RRJETIT NDËRURBAN KABLLOR ME FIBËR OPTIKE” NË AKSET NACIONALE RRUGORE NË TË GJITHË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE “QENDRA PËR SHKËMBIMIN E INTERNETIT DHE PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE BIX – TIRANA” ISH-KOMUNA BËRXULLË, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, VKM-së nr. 877, datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për punimet civile të “Rrjetit Ndërrurban Kabllor me Fibër Optike” në akset Nacionale Rrugore në të gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë, Dhe “Qendra për shkëmbimin e Internetit dhe përpunimit të të dhënave BIX – Tirana”, Ish-Komuna Bërxullë, Bashkia Tiranë, me subjekt kërkues Operatorin “UNIFI Holdings” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
 - b. Harta e Planvendosjes së Rrjetit Ndërrurban Kabllor në të gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë dhe godinës së administratës në shërbim, në Komunën Bërxullë.
3. Ngarkohet Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësitve të Qeverisjes Vendore, sipas listës dhe preventivit përkatës.



5. Ngarkohet Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Njësitë e Qeverisjes Vendore ku shtrihet projekt për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA

ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENI



MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



Z. EDMOND HAXHINASTRO

MINISTËR I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT